

# Shoqata „Greikoci“

## Raporti vjetor 2022

Ossingen ZH (Zvicër), 26 dhjetor 2022

### Hyrje

Me rastin e mbylljes së vitit 2022, shoqata «Greikoci» falënderon të gjithë anëtarët, sponsorët dhe kontribuesit për mbështetjen e tyre financiare dhe morale përgjatë këtij viti. Njëkohësisht, falënderon tre punëtorët, të cilët janë të angazhuar në Greikoc, për ta mundur një ambient të pastër, qysh nga viti 2016.

Gjatë këtij viti, shoqata «Greikoci» ishte e fokusuar për ta realizuar sa më mirë parkun «Te Gryka». Parku «Te Gryka» përfshin: shtigje për ecje apo vrapim, diku deri në 2 km; 2 kënde me lodra për fëmijë; 3 hapësira për skarë, hapësira e pushimore të gjelbëruara dhe gjolin e rivitalizuar, i cili ka qenë projekt më vete, po në këtë vit.

Njëkohësisht ju njoftojmë se rrënimi i parkut «Dëshmorët» (i cili është realizuar nga shoqata «Greikoci», në vitin 2016 dhe kap një vlerë mbi 15 000 euro) është jo i koordinuar dhe i njëanshëm nga ana e kryesisë së fshatit dhe i organizatës së veteranëve të fshatit. Ne, si shoqatë dhe investitor jemi ankuar tek autoritetet përkatëse, që ky park nuk bën të rrënohet. Se a do të rregullohen hapësira të gjelbra, me kënde lodrash për fëmijët te lapidari (sheshi) i ardhshëm i përfolur mbetet të shihet nga iniciatorët e projektit të ri dhe nga komuna e Suharekës?

### Parku «Te Gryka» (janar – dhjetor 2022)

Investime të mëtutjeshme vazhduan në parkun e ri «Te Gryka», i cili ka filluar të rregullohet nga shoqata «Greikoci» në vitin 2021. Ndër të tjerash, në këtë park janë vendosur: një kosh, një hambar, pastaj rregullimi i disa stogjeve, si dhe kanë vazhduar punime të ndryshme renovuese në pjesën e Gjolit dhe mbjellja e lisave dekorativë. Ju njoftojmë që zyrtarisht më 31 korrik 2022 u bë inaugurimi i këtij parku ku ishte edhe prezent kryetari i komunës Bali Muharremaj.



### Shkronjat e UÇK-së (janar - shkurt 2022)

Me kërkesën e kryesisë së fshatit dhe organizatës së veteranëve të UÇK-së së fshatit, shoqata «Greikoci» ka dhuruar 1000 euro për realizimin e këtij projekti. Sipas informatave të iniciatorëve në fjalë punimet në projektin në fjalë janë ende duke vazhduar dhe inaugurimi i këtij projekti do të ndodhë në vitin 2023.




### Rroba për nxënësit (mars 2022)

Pas një kërkesë, që bëri drejtori i shkollës së fshatit Greikoc është bërë financimi i 28 uniformave shkollore, për nxënësit me kushte të dobëta financiare.

### Revista e SHFMU «Dëshmorët e Greikocit» nr. 14 [prill 2019]

Për të pestën herë, shoqata «Greikoci» financoi botimin e revistës së shkollës fillore «Dëshmorët e Greikocit». Kjo revistë botohet çdo vit (në prill) për nder të dëshmorëve të fshatit të rënë në luftën e fundit (1998 dhe 1999) në Kosovë. Botues i revistës është Këshilli i shkollës. Revista përmban punime të ndryshme, si: poezi, vizatime, rrëfime apo intervista të nxënësve dhe të mësuesve të shkollës fillore të fshatit Greikoc.



### KF Greikoci (mars 2022)

Në mënyrë që KF «Greikoci» të ketë kushte më të lehta për punë, shoqata «Greikoci» ka ndarë 600 euro për këtë klub futbolli. Pasi që kryetari i KF «Greikoci», Kadri Canaj është pensionuar dhe ky ekip nuk ka arritur që të gjejë udhëheqës, fatkeqësisht KF «Greikoci» ka shuar aktivitetin e vet.



### Iftari 2022 (prill 2022)

Shoqata «Greikoci» organizon iftar publik për burra dhe për gra disa vite me radhë. Kjo traditë, ku shërben për t'u takuar banorët e Greikocit është e mirëpritur shumë dhe ka shumë pjesëmarrës, sidomos, nga gjinia femërore.



### Dhurata për fëmijë për Kurban Bajram (korrik 2022)

Për të parën herë, shoqata «Greikoci» përgatiti dhurata për fëmijët e fshatit, me rastin e Kurban Bajramit. Ishte iniciativë e një bije të Greikocit – Elvana Haxhaj. Ky gjest u mirëprit nga i gjithë komuniteti i fshatit. Brenda këtij aksioni u shpërndanë 150 dhurata për fëmijët e fshatit deri në klasën e tretë.



### Sistemi solar te Xhamia (korrik 2022)

Shoqata «Greikoci» mbështeti realizimin e projektit të pajisjes me solar të Xhamisë së Greikocit. Ky projekt kap shifrën prej me 500 eurosh. Projekti në fjalë është cilësuar si i nevojshëm, sidomos, për ta vetëdijësuar komunitetin në përgjithësi për të prodhuar energji alternative, të cilat nuk e dëmtojnë ambientin.



### Turneu i futbollit (korrik 2022)

Për nder të sportistit, Halil Kicaj (aktivist i shquar i sportit në Greikoc), shoqata «Greikoci» më 31 korrik 2022, vendosi që të organizojë dy ndeshje futbolli: një për seniorë dhe një për juniorë, ku në këtë kohë shumica e banorëve (mërgimtarëve) të Greikocit ishin për pushime



### Busi për punëtorët e mirëmbajtjes (tetor 2022)

Pas amortizimit të tepërt të goldonit, shoqata «Greikoci» vendosi për blerjen e një busi. Ky bus është vënë në shërbim të dy punëtorëve të shoqatës, të cilët janë të angazhuar për mirëmbajtjen e fshatit.

### Rreth shoqatës „Greikoci“:

Themelimi: 17 maj 2015  
Selia: Ossingen ZH – Zvicër  
Numri i anëtarëve: mbi 220  
Kryetar: Rexhep Neziraj (+41 79 489 49 92)  
Webfaqja: [www.greikoci.ch](http://www.greikoci.ch)  
Kontakt: [shoqata\\_greikoci@gmx.ch](mailto:shoqata_greikoci@gmx.ch)  
Facebook: Shoqata Greikoci

### Synimet për vitin 2023

Për vitin 2023, kryesia e Shoqatës ka vendosur që të vazhdojë fokusin kryesor për mirëmbajtjen e ambientit të fshatit Greikoc. Gjithashtu, do të përkrahë në vazhdimësi projekte, ku mbështeten të rinjtë e fshatit Greikoc. Projektet konkrete do të pasojnë gjatë pranverës së vitit 2023.